



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs

Akademia e Kosovës për Siguri Publike
Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost / Kosovo Academy for Public Safety

PLANI VJETOR I PERFORMANCËS

AKSP - 2026



Tetor, 2025

1. Hyrje

Akademia e Kosovë për Siguri Publike bazuar në Ligjin Nr. 04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike / AKSP është agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme/MPB.

Misioni i AKSP është përcaktuar në bazë të ligjit Nr. 04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike/AKSP ku *AKSP është përgjegjëse për ofrimin e trajnimeve dhe arsimit të lartë, zbatimin e politikave dhe strategjive të trajnimit dhe të arsimit të lartë, si dhe zhvillimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë publike.*

AKSP i ofron shërbimet e lartpërmendura për të gjitha institucionet e sigurisë publike por pa u kufizuar vetëm në: Policinë e Kosovës(PK), Shërbimin Korrektues të Kosovës (SHKK), Doganat e Kosovës (DK), Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME), Inspektoratin e Policisë së Kosovës (IPK) dhe Shërbimin Sprovues të Kosovës (SHSK).

Krijimi i dokumentit të Planit të Performancës ka filluar në fillim vit me diskutimin e projekt buxhetit ndërsa zyrtarisht me krijimin e grupit punues të institucionit duke përfshirë të gjitha njësit organizative të AKSP-së. Ky grup punues ka zhvilluar takime të shumta rreth formësimit të ideve dhe objektivave vjetore performuese të institucionit.

Plani performancës i AKSP-së për vitin 2026 është hartuar duke u bazuar në analizimin e gjendjes aktuale dhe proceseve në të cilat gjendet institucioni ku si rezultat janë përcaktuar edhe objektivat për avancimin dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të AKSP-së duke i ndërlidhur ato edhe me objektivat e dokumenteve tjera strategjike si:

- **Planin Kombëtar për Zhvillim Qeverisë së Republikës së Kosovës 2025 – 2027**
- **Strategjisë zhvillimore të AKSP-së 2023-2026**
- **Standardet e Agjencisë së Kosovës për Akreditim, Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve dhe standardet ndërkombëtare akredituese IADLEST-SHBA.**

Trajnimi dhe arsimimi i zyrtarëve të sigurisë si faktor kyç në ngritjen e sigurisë publike është sfidë me shumë dimensione. Andaj përmes këtij plani synojmë t'i avancojmë njohuritë dhe shkathtësitë e duhura për të gjithë pjesëtarët e Institucioneve të sigurisë publike duke u bazuar në **praktikat dhe standardet** më të mira vendore dhe ndërkombëtare në fushën e trajnimit dhe arsimimit.

Të gjitha këto objektiva do të konkretizohen duke përcaktuar qartë planin e veprimit si pjesë përbërëse të dokumentit i cili parasheh orientimin dinamik dhe rezultatin konkret për secilin aktivitet.

2. Përmbledhje Ekzekutive

Akademia e Kosovës për Siguri Publike /AKSP duke u bazuar në dispozitat përkatëse ligjore të parapara me Ligjin Nr. 06/L -113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura, Rregullores (QRK) Nr. 12/2023 mbi sistemin e menaxhimit të performancës për agjencitë në kuadër të administratës shtetërore, ka hartuar planin vjetor të performancës 2026.

AKSP udhëhiqet nga Drejtori i Përgjithshëm i cili përfaqëson, organizon dhe koordinon punën e institucionit. Po ashtu Drejtori kryen të gjitha detyrat e Zyrtarit Kryesor Administrativ në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

AKSP-ja synon çdo herë t'i përcjellë dhe të jetë në hap me trendet e zhvillimit në fushën e sigurisë publike duke adaptuar mekanizmat e saj me qëllim të ngritjes së vazhdueshme profesionale të zyrtarëve të sigurisë publike. Plan i performancës i AKSP-së është adaptuar konformë kërkesave dhe nevojave të Institucioneve të Sigurisë Publike. Edhe ky dokument ka përcaktuar objektivat, aktivitetet dhe rezultatet me qëllim të implementimit të një politike efektive që do të ndërmerret në vitin 2026.

Fokusi i AKSP-së do të orientohej në ofrimin, hartimin dhe digjitalizimin e proceseve trajnuese, avancimin e menaxhimit të proceseve dhe ndërkombëtarizimin e AKSP-së në asociacione rajonale dhe ndërkombëtare. Këto fusha janë me interes të veçantë për institucionin tonë dhe palët e interesit sepse të gjitha këto kanë qëllimin e përbashkët avancimin e kapaciteteve të Institucioneve të Sigurisë Publike.

Me qëllim të përmbushjes së misionit të saj, AKSP synon të realizojë objektivat e parapara në kuadër të planit të performancës për vitin 2026 si vijim:

- 1. Ofrimi, zhvillimi dhe modernizimi i programeve trajnuese.**
- 2. Fuqizimi i funksionimit të brendshëm, planifikimit dhe sistemeve të menaxhimit institucional**
- 3. Zhvillimi i bashkëpunimit vendor dhe ndërkombëtar dhe rritja e rolit të Akademisë në rrjetet rajonale dhe ndërkombëtare të sigurisë publike**

Në kuadër të zbatimit të obligimeve të përcaktuara me këtë Plan të Përformancës për vitin 2026, AKSP ka paraparë veprimet dhe masat që do të ndërmerren në realizimin e këtij plani dhe do të sigurojë monitorim dhe raportim të rregullt periodik për të siguruar realizimin e objektivave të përcaktuara nga njësitë organizative.


AKSP-ja ka të rregulluar sistemin e brendshëm të organizimit sipas Rregullore (QRK) Nr. 05/2014 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike dhe funksionon e organizuar në njësi si; Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm, Fakulteti i Sigurisë Publike, Departamente dhe

Divizione. Tashmë AKSP është në fazën e ri-organizmit të strukturës së brendshme organizative e cila pritet të miratohet.

Bazuar ne Ligjin Nr.04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike personeli i AKSP-se ndahet ne: personel menaxhues; personel trajnues dhe mësimdhënës dhe personel mbështetës;

Numri i vendeve të punës me buxhet e përcaktuar është 156 ndërsa numri aktual i të punësuarve është 125.

Struktura organizative



Po ashtu AKSP-ja posedon buxhetin e organizatës në total prej 3,799,079.00 € si dhe posedon pajisjet efektive teknologjike dhe logjistike për implementimin e objektivave të parapara në këtë plan.

3. Hyrje

AKSP u themelua në dhjetor të vitit 2011 me hyrjen në fuqi të ligjit Nr. 04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike/AKSP sipas të cilit AKSP-ja është agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme/MPB.

Misioni i AKSP është përcaktuar në bazë të ligjit Nr. 04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike/AKSP ku *AKSP është përgjegjëse për ofrimin e trajnimeve dhe arsimit të lartë, zbatimin e politikave dhe strategjive të trajnimit dhe të arsimit të lartë, si dhe zhvillimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë publike.*

AKSP i ofron shërbimet e lartpërmendura për të gjitha institucionet e sigurisë publike por pa u kufizuar vetëm në: Policinë e Kosovës(PK), Shërbimin Korrektues të Kosovës (SHKK), Doganat e Kosovës (DK), Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME), Inspektoratin e Policisë së Kosovës (IPK) dhe Shërbimin Sprovues të Kosovës (SHSK).

Krijimi i dokumentit të Planit të Performancës ka filluar në fillim vit me diskutimin e projekt buxhetit ndërsa zyrtarisht me krijimin e grupit punues të institucionit duke përfshirë të gjitha njësit organizative të AKSP-së. Ky grup punues ka zhvilluar takime të shumta rreth formësimit të ideve dhe objektivave përformuese të institucionit.

Plani performancës i AKSP-së për vitin 2025 është hartuar duke u bazuar në analizimin e gjendjes aktuale dhe proceseve në të cilat gjendet institucioni ku si rezultat janë përcaktuar edhe objektivat për avancimin dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të AKSP-së duke i ndërlidhur ato edhe me objektivat e dokumenteve tjera strategjike si:

- **Planin Kombëtar për Zhvillim Qeverisë së Republikës së Kosovës 2025 - 2027**
- **Strategjisë zhvillimore të AKSP-së 2023-2026**
- **Standardet e Agjencisë së Kosovës për Akreditim, Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve dhe standardet ndërkombëtare akredituese IADLEST-SHBA.**

Trajnimi dhe arsimimi i zyrtarëve të sigurisë si faktor kyç në ngritjen e sigurisë publike është sfidë me shumë dimensione. Andaj përmes këtij plani synojmë t'i avancojmë njohuritë dhe shkathtësitë e duhura për të gjithë pjesëtarët e Institucioneve të sigurisë publike duke u bazuar në **praktikat** dhe **standardet** më të mira vendore dhe ndërkombëtare në fushën e trajnimit dhe arsimit.

Të gjitha këto objektiva do të konkretizohen duke përcaktuar qartë planin e veprimit si pjesë përbërëse të dokumentit i cili parasheh orientimin dinamik dhe rezultatin konkret për secilin aktivitet.

4. Përmbledhje e Objektivave

Objektivat të cilat i kemi potencuar në përmbledhjen ekzekutive, kërkojnë veprime të vazhdueshme gjatë tërë vitit 2026, të cilat i kemi paraparë në planin e performancës. Me qëllim të përmbushjes së misionit dhe vizionit të saj, AKSP-ja synon të realizojë këto objektiva si në vijim:

Objekti i 1: Ofrimi, zhvillimi dhe modernizimi i programeve trajnuese

Në kuadër të përmbushjes së mandatit ligjor dhe objektivave strategjike, AKSP është e angazhuar në zbatimin e një sërë aktiviteteve që synojnë forcimin dhe modernizimin e sistemit të trajnimeve për zyrtarët e sigurisë publike. Përmes zbatimit të planit vjetor të trajnimeve dhe organizimit të trajnimeve profesionale dhe trajnimeve në nivele të ndryshme, synohet ofrimi i programeve që adresojnë prioritetet e sigurisë publike dhe zhvillimin e aftësive profesionale në përputhje me kërkesat institucionale. AKSP-ja po krijon standarde dhe mekanizma për ngritjen e cilësisë në politikën e trajnimit dhe arsimimit për zyrtarët e sigurisë publike falë bashkëpunimit dhe anëtarësimit në shumë organizata ndërkombëtare, akreditimeve vendore dhe ndërkombëtare, përkrahjes së vazhdueshme të partnerëve strategjik si ICITAP dhe OSBE.

Një rëndësi të veçantë zë hartimi i trajnimeve të reja që reflektojnë trendët bashkëkohorë të sigurisë dhe dokumentet strategjike në fuqi, si dhe forcimi i kapaciteteve logjistike dhe infrastrukturore për sigurimin e kushteve optimale të zhvillimit të trajnimeve. Paralelisht, AKSP po punon në zhvillimin e materialeve didaktike dhe platformës digjitale për trajnime (E-trajnimi), që mundëson mësimdhënie dhe vlerësim më efikas përmes teknologjisë moderne.

Gjithashtu, një komponent kyç mbetet validimi i gjashtë trajnimeve profesionale dhe bazike nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, si hap i standardizimit dhe njohjes zyrtare të programeve të trajnimit. Nëpërmjet këtyre veprimeve të integruara, AKSP synon ngritjen e vazhdueshme të cilësisë, efikasitetit dhe profesionalizmit në ofrimin e trajnimeve për zyrtarët e sigurisë publike të Republikës së Kosovës.

Aktivitetet: Për arritjen e këtij objekti nevojiten edhe shumë veprime dhe aktivitete të ndryshme të koordinuara dhe planifikuara si vijon:

- Implementimi i planit vjetor të trajnimeve;
- Organizimi i trajnimeve profesionale;
- Krijimi i trajnimeve të reja sipas trendëve të sigurisë publike, nevojave të ISP-ve dhe dokumenteve strategjike;
- Rritja e kapaciteteve logjistike dhe infrastrukturore për zhvillimin e trajnimeve;
- Zhvillimi i materialeve didaktike dhe platformës digjitale për trajnime (E-trajnimi);
- Validimi i gjashtë (6) trajnimeve profesionale/bazike nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve.

Objektivi 2: Fuqizimi i funksionimit të brendshëm, planifikimit strategjik dhe sistemeve të menaxhimit institucional

Gjatë periudhës 2026, Akademia e Kosovës për Siguri Publike synon forcimin e kapaciteteve institucionale dhe rritjen e efektivitetit në përmbushjen e misionit të saj përmes një qasjeje të integruar zhvillimore. Në këtë kuadër, prioritet mbetet hartimi dhe miratimi i Strategjisë Institucionale AKSP 2027–2030, e cila do të përcaktojë drejtimet kryesore të zhvillimit, objektivat afatmesme dhe masat për përmirësimin e performancës dhe cilësisë së shërbimeve.

Paralelisht, Plani i Integritetit 2027–2028 do të shërbejë si instrument për forcimin e transparencës, etikës profesionale dhe llogaridhënies brenda institucionit.

Një tjetër shtyllë kyçe e zhvillimit institucional është digjitalizimi i menaxhimit të proceseve trajnuese, që synon automatizimin dhe modernizimin e sistemeve të testimit dhe vlerësimit të trajnimeve për të siguruar efikasitet dhe cilësi të lartë.

Po ashtu, funksionalizimi i sistemit të menaxhimit të dokumenteve do të mundësojë menaxhim më të sigurt, transparent dhe efikas të informacionit dhe dokumentacionit institucional ku do të ndikoj edhe në ngritjen e integritetit, llogaridhënies dhe përgjegjësisë.

Nëpërmjet këtyre ndërhyrjeve strategjike, AKSP synon të ndërtojë një institucion më të qëndrueshëm, transparent dhe të orientuar drejt inovacionit, integritetit dhe rezultateve të matshme.

Aktivitetet: Për arritjen e këtij objektivi nevojiten edhe shumë veprime dhe aktivitete të ndryshme të koordinuara dhe planifikuara si vijon:

- Hartimi dhe miratimi i Strategjisë Institucionale - AKSP 2027–2030;
- Hartimi dhe miratimi i Planit të Integritetit AKSP 2027-2028;
- Digjitalizimi i menaxhimit të proceseve trajnuese;
- Funksionalizimi i sistemit të menaxhimit të dokumenteve.

Objektivi 3: Zhvillimi i bashkëpunimit vendor dhe ndërkombëtar dhe rritja e rolit të Akademisë në rrjetet rajonale dhe ndërkombëtare të sigurisë publike

AKSP synon të zgjerojë dhe thellojë bashkëpunimin me institucionet vendore dhe ndërkombëtare të sigurisë publike me qëllim shkëmbimin e përvojave, praktikave të mira dhe standardeve profesionale në fushën e trajnimit dhe zhvillimit të kapaciteteve. Përmes anëtarësimit aktiv në rrjete rajonale dhe ndërkombëtare, pjesëmarrjes në projekte të përbashkëta dhe nismave profesionale, Akademia synon të rrisë rolin dhe ndikimin e saj si qendër referente e ekspertizës dhe inovacionit në trajnimin e zyrtarëve të sigurisë publike.

Ky objektivi synon të kontribuojë në ndërtimin e partneriteteve të qëndrueshme, në përmirësimin e cilësisë së programeve trajnuese dhe në promovimin e AKSP-së si institucion bashkëkohor, i integruar në rrjedhat ndërkombëtare të zhvillimit të kapaciteteve të sigurisë publike. Këto veprime synojnë forcimin e pozitës së Akademisë, shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira, si dhe ndërtimin e partneriteteve të qëndrueshme që kontribuojnë në zhvillimin institucional dhe profesional.

Aktivitetet: Për arritjen e këtij objektivi nevojiten edhe shumë veprime dhe aktivitete të ndryshme të koordinuara dhe planifikuara si vijon:

- *Mobiliteti dhe shkëmbimi i përvojave me partnerët ndërkombëtar përmes pjesëmarrjes në aktivitete, vizita dhe trajnime ndërkombëtare;*
- *Nënshkrimi i marrëveshjeve të reja të bashkëpunimit me akademi, institucione të sigurisë dhe arsimit;*
- *Organizimi i vizitave, trajnimeve dhe konferencave të përbashkëta;*
- *Përfaqësimi i Akademisë në asociacione rajonale, ndërkombëtare dhe forume profesionale;*
- *Rritja e transparencës përmes publikimeve në web dhe mediat sociale.*

5. Ndikimi buxhetor – Menaxhimi Financiar

Për realizimin e këtij plani të performancës për vitin 2026 sipas llogaritjeve të aktiviteteve nevojitet buxhet prej 1,531,000.00 € i cili është i aprovuar si draft buxhet dhe i shpërndarë në kode buxhetore të AKSP-së për vitin 2026. Të gjitha aktivitetet e parapara në këtë plan të performancës janë të mbuluara dhe harmonizuara me buxhet të shpërndarë nëpër kode buxhetore sipas tabelave.

AKSP sipas Ligjit të buxhetit për vitin 2025 dhe sipas Draft Ligjit për buxhet për vitin 2026 (Qarkores buxhetore 2026/01 të pranuar nga AKSP) ka të lejuar buxhetin e përgjithshëm sipas kufijve buxhetore si më poshtë:

Tabela e buxhetit AKSP 2025		
AKSP - 2025	Kategoritë ekonomike	Buxheti i Aprovuar
	Paga & Mëditje	1,223,543.00
	Mallra dhe Shërbime	1,614,221.00
	Shpenzime Komunaleve	144,030.00
	Shpenzime Kapitale	817,285.00
	Total	3,799,079.00

Tabela e draft buxhetit AKSP 2026 Qarkore 2026/01		
AKSP - 2026	Kategoritë ekonomike	Buxheti i Aprovuar
	Paga & Mëditje	1,338,395.00
	Mallra dhe Shërbime	1,614,221.00
	Shpenzime Komunaleve	144,030.00
	Shpenzime Kapitale	817,285.00
	Total	3,913,934.00

AKSP-ja për vitin 2026 ka kërkuar edhe buxhet shtesë në vazhdimësi gjatë hartimit të propozimeve për Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve/KASH 2026-2028 për realizimin e disa objektivave të cilat janë vlerësuar si shumë të rëndësishme për proceset e AKSP-së si vijon:

- *Funksionalizimi i objektit të Fakultetit për Siguri Publike me furnizim me inventar dhe kabinete, laboratorë etj në vlerë 300,000.00 €.*
- *Shtesë në paga në vlerë 211,043.00 € për pozitat e pa plotësuara, transferimin e instruktorëve në AKSP (Ligji i AKSP-së ka përcaktuar që një pjesë e personelit trajnues të angazhohet nga institucionet e sigurisë publike si: PK, DK, SHKK, SHSK, IPK dhe AME në AKSP në periudha kohore deri në 3 vite), staf akademik i angazhuar, ekspert për trajnime, rrjeti mentorëve për intershipe etj.*
- *Kërkesa për furnizim me ushqim dhe pije për kadet në vlerë 1,000,000.00 €*
- *Renovimet në AKSP në vlerë për 100,000.00€*

Pas shqyrtimeve dhe dëgjimeve buxhetore nuk kemi pasur ndonjë aprovim të kërkesave shtesë për vitin 2026 mirëpo sipas draft buxhetit për vitin 2026 kemi pranuar **rritje buxhetore** në dy kategori:

- ❖ *Kategoria paga dhe mëditje nga viti 2025 rritje në vlerë prej 64,446.01 € si dhe*
- ❖ *Kategoria Mallra dhe shërbime nga viti 2025 rritje në vlerë prej 250,000.00 €*

AKSP-ja është duke hartuar kërkesa për plotësimin e nevojave edhe me burime tjera financiare me donatorët, por ende nuk kemi asnjë projekt final të miratuar për zbatim në vitin 2026. Si rezultat i trendëve të rritjes së çmimeve në kontratat për shërbime është reduktuar edhe planifikimi i numrit të pjesëmarrësve në trajnime për vitin 2026 për 10%.

A. Pjesa tabelore e Planit të Përformancës

Data		31/10/2025				
Agjencia		AKADEMIA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE				
Ministria përgjegjëse		MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME				
Misioni i Agjencisë		<i>Misioni i Akademisë është të ofroj trajnim, arsimim dhe hulumtim me cilësi të lartë në fushën e sigurisë publike për të ndihmuar në ofrimin e ambientit të sigurtë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës</i>				
Nr.	Objektivi	Treguesit		Vlera bazë (2025)	Vlera e synuar (2026)	Referenca në dokumente strategjike/politike
1	Ofrimi, zhvillimi dhe modernizimi i programeve trajnuese	Numri i zyrtarëve të trajnuar		2100	2000	➤Strategjia Zhvillimore AKSP 2023-2026 ➤Plani Kombëtar për Zhvillim -QRK 2025-2027 (Siguria dhe sundimi ligjit shtylla 3) ➤Korniza Kombëtare e kualifikimeve
		Trajtime Profesionale te Validuara		0	6	
		Numri i trajnimeve të reja		3	4	
Aktivitetet kryesore		Njësia përgjegjëse	Afati i zbatimit	Alokimi financiar	Burimi i financimit	Outputet/ Produkti
1.1. Implementimi i planit vjetor të trajnimeve		DTPA	K1-K4	400,000.00 €	Buxheti RKS	Organizimi dhe mbajtja e trajnimeve sipas planifikimit vjetor të trajnimeve duke trajnuar rreth 1500 zyrtar ISP-ve
1.2. Organizimi i trajnimeve profesionale		DTPA/ISP	K1-K4	280,000.00 €	Buxheti RKS	Së paku 4 trajtime profesionale të përfunduara duke trajnuar rreth 530 kadetë nga ISP-të
1.3. Krijimi i trajnimeve të reja sipas trendëve të sigurisë publike, nevojave të ISP-ve dhe dokumenteve strategjike		DTPA	K1-K4	1,000.00 €	Buxheti RKS	Së paku katër (4) trajnime të reja të zhvilluara
1.4. Rritja e kapaciteteve logjistike dhe infrastrukturore për zhvillimin e trajnimeve		DFSHP	K1-K4	817,000.00€	Buxheti RKS	Ndërtimi i objektit të mensës moderne
1.5. Zhvillimi i materialeve didaktike dhe platformës digjitale për trajnime (E-trajnimi)		DTPA/DTI	K1-K4	Kosto administrative	Buxheti RKS	Platforma e funksionalizuar

1.6. Validimi i gjashtë (6) trajnimeve profesionale nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve		DSC/ISP	TM4	10,000.00€	Buxheti RKS	Trajnimet profesionale të validuara nga AKK-ja
Buxheti i përgjithshëm për Objektivin 1:					1,508,000.00 €	
Nr.	Objektivi	Treguesit		Vlera bazë (2025)	Vlera e synuar (2026)	Referenca në dokumente strategjike/politike
2	Fuqizimi i funksionimit të brendshëm, planifikimit strategjik dhe sistemeve të menaxhimit institucional	Dokumentet planifikuese miratuara		0	2	➤ Strategjia Zhvillimore AKSP 2023-2026
		Procese të digjitalizuara		0	2	
Aktivitetet kryesore		Njësia përgjegjëse	Afati i zbatimit	Alokimi financiar	Burimi i financimit	Outputet / Produkti
2.1. Hartimi dhe miratimi i Strategjisë Institucionale të AKSP-së për periudhën 2027–2030		DPSC/L/Të gjitha njësitë	TM2-TM4	Kosto administrative	Buxheti RKS	Strategjia institucionale e re e miratuar dhe e zbatuar
2.2. Hartimi dhe miratimi i Planit të Integritetit AKSP 2027-2028		DPSC/L/ Të gjitha njësitë	TM3-TM4	Kosto administrative	Buxheti RKS	Plani i integritetit i miratuar
2.3. Digjitalizimi i menaxhimit të proceseve trajnuese		DTI/DTPA/ DSC	TM1-TM4	Kosto administrative	Buxheti RKS	- Testimi elektronik - Vlerësimi trajnimeve
2.4. Funksionalizimi i sistemit të menaxhimit të dokumenteve		DFSHP/ të gjitha njësitë	TM1-TM4	Kosto administrative	Buxheti RKS	Proceset i qarkullimit të dokumenteve i hartuar dhe aplikuar
Buxheti i përgjithshëm për Objektivin 2:					00,00 €	
Nr.	Objektivi	Treguesit		Vlera bazë (2025)	Vlera e synuar (2026)	Referenca në dokumente strategjike/politike
3	Zhvillimi i bashkëpunimit vendor dhe ndërkombëtar dhe rritja e rolit të Akademisë në rrjetet rajonale dhe ndërkombëtare të sigurisë publike	Numri i pjesëmarrësve në mobilitete ndërkombëtare		10	15	➤ Strategjia Zhvillimore AKSP 2023-2026
		Numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit		1	2	
		Pjesëmarrja ne aktivitete të përbashkëta rajonale dhe ndërkombëtare		5	5	

Aktivitetet kryesore	Njësia përgjegjëse	Afati i zbatimit	Alokimi financiar	Burimi i financimit	Outputet / Produkti
3.1. Mobiliteti dhe shkëmbimi i përvojave me partnerët ndërkombëtar përmes pjesëmarrjes në aktivitete, vizita dhe trajnime ndërkombëtare	DMJ	K1-K4	10,000.00€	Buxheti RKS / Donacione	Të paktën 15 zyrtar pjesëmarrës në programe shkëmbimi mobiliteti (CEPOL, IPA dhe partneritete tjera)
3.2. Nënshkrimi i marrëveshjeve të reja të bashkëpunimit me akademi, institucione të sigurisë dhe arsimit	ZDP/DMJ	K1-K4	Kosto administrative	Buxheti RKS	Së paku 2 marrëveshje bashkëpunimi të nënshkruara
3.3. Organizimi i tryezave, seminareve dhe konferencave shkencore nga AKSP	FSP	K1-K4	3,000.00 €	Buxheti RKS / Donacione	Së paku 2 ngjarje të organizuara në AKSP
3.4. Përfaqësimi i Akademisë në asociacione ndërkombëtare dhe forume profesionale	AKSP	K1-K4	10,000.00 €	Buxheti RKS / Donacione	Së paku 5 përfaqësime nga AKSP në ngjarje ndërkombëtare apo asociacione ku AKSP është anëtare
3.5. Rritja e transparencës përmes publikimeve në ueb dhe mediat sociale	DMJ/AKSP	K1-K4	Kosto administrative	Buxheti RKS	Të gjitha ngjarjet dhe aktivitetet e publikuara
Buxheti i përgjithshëm për Objektivin 3:				23,000.00 €	

Ushtrues i Detyrës
Drejtorit të Përgjithshëm të AKSP-së

Shpend Shabani

Njësia Përgjegjëse në MPB

1. B. XHEJAT SVEÇJA
2. MINISTER
3. Pe